

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

RAPORTI VJETOR

2019

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje	3
1. Vlerësimi dhe ekzekutimi financiar të vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit	4
1.1. Vlerësimi Financiar i Vendimimeve përfundimtare	4
1.2. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare	5
1.3. Për përfitimin e shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)	7
1.4. Për procesin e tjetërsimit të sipërfaqeve të shtetërore (oborreve në përdorim)	7
2. Trajtimi i numrit të kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara të ndara sipas qarkut dhe në shkallë vendi si dhe për llojin e pasurisë së pretenduar	8
2.1. Trajtimi i kërkesave të reja të depozituara për njohje pronësie.....	8
2.2. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim	9
3. Çështjeve të ndjekura e të ankimuara në gjykatë dhe ekzekutimi i tyre.....	10
4. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucione të tjera.....	11
4.1. Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të ligjit 133/2015.....	11
4.2. Raportime periodike Mijore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS)	11
5. Kërkesa të depozituara pranë sporteleve të atp-së si dhe ankesa të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes.....	13
5.1. Kërkesa të depozituara në sportelet e ATP-së.....	13
5.2. Ankesa të trajtuara të ardhura nga portali i bashkëqeverisjes.....	13
5.2.1. Agjencia e Trajtit të Pronave ka kryer raportimin periodik për vitin 2019 në kuadër të monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2020	13
5.2.2. Pranë Agjencisë së Trajtit të Pronave janë trajtuar ankesat të paraqitur nga nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes me qytetarët.....	14
5.3. Shërbime të ofruara nga ATP nga bashkëpunimi ndërmjet AKSHI dhe ADISA	15
6. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompesimit	15
6.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2019 duke u bazuar në 12 mujor deri në 26.12.2019, i pa kuadruar nga dega e thesarit.....	15
6.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, për vitin 2019	16

Hyrje

Agjencia e Trajtimit të Pronave është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe ushtron aktivitetin në zbatim të Ligjit 133/2015 *“Për Trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”* si dhe akteve nënligjore VKM nr.221/2016; VKM nr.222/2016 e ndryshuar me VKM nr.765/ 2017; VKM nr.223/2016 të ndryshuar me VKM nr.766/2017.

Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP), në zbatim të pikës 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.221, datë 23.3.2016, *“Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave”*, paraqet raportin vjetor të punës për periudhën janar-dhjetor 2019. Ky raport reflekton punën e ATP përgjatë vitit 2019 duke dhënë informacionin për objektivat e arritura gjatë këtij viti.

Agjencia e Trajtimit të Pronës ka përfunduar një nga proceset më të rëndësishme, që është ai i Vlerësimeve financiare të vendimeve përfundimtare për vitet 1993-2013 që kanë njohur të drejtën e kompensimit me qëllim nxjerrjen e një fature financiare përfundimtare.

Për gjatë katër viteve ATP ka vijuar me Kompensimin financiar dhe fizik të vendimeve përfundimtare, me vlerë financiare rreth 5.8 mld dhe shpërndarë fond fizik nga fondi i tokës 612.3 ha, . Ndërsa për periudhën 10 vjeçare, nga hyrja në fuqi e ligjit, ATP është e ngarkuar që të kryej ekzekutimin e vendimeve përfundimtare që janë vlerësuar financiarisht sipas mënyrës dhe të formave të përcaktuara në VKM 223/2016, të ndryshuar. ATP do të vijojë më tej me ekzekutimin e aplikimeve të administruara si dhe aplikimet e reja që do të vijnë sipas akteve nënligjore për 6 vitet në vijim.

Për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie (proces i përfunduar më 23.02.2019) ATP-ja ka proceduar pas përfundimit të afatit për kërkesat e patrajtuara mbështetur në pikën 2 të nenit 34 të Ligjit Nr. 133/2015, në të cilin citohet se: *Nëse ATP-ja nuk përmbush detyrimin për të trajtuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, brenda afatit 3-vjeçar, atëherë subjektet mund t’i drejtohen gjykatës së shkallës së parë për të trajtuar kërkesën e tyre, sipas përcaktimeve të këtij ligji”*. Agjencia e Trajtimit të Pronave gjatë periudhës raportuese ka vijuar me njoftimet zyrtare për tërheqje dosje, të subjekteve të cilët vijnë në cilësinë e trashëgimtarit ligjor/përfaqësues me prokurë (ky numër i referohet numrit të dosjeve), për të tërhequr dokumentacionin tekniko/ligjor të depozituar, në mënyrë që të fillojnë me procedurat pranë gjykatës së shkallës së parë. Nga subjektet po vijon procesi i kërkesave dhe tërheqjes së dosjeve nga ATP.

Agjencia e Trajtimit të Pronës ka kryer përditësim dhe publikim të rregullt të informacionit të ATP-së, duke përfshirë informacione *për aktet dhe vendimet administrative ose gjyqësore*. Përditësimet publikohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të internetit të ATP-së kryesisht www.atp.gov.al.

1. Vlerësimi dhe ekzekutimi financiar të vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit


1.1. Vlerësimi Financiar i Vendimeve përfundimtare

Gjatë vitit 2019, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vijuar punën me vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare për kompensim, **duke përfunduar vlerësimin financiar të 1558 vendimeve**, në të cilat përfshihen vlerësime të vendimeve të papublikuara më parë dhe rivlerësim të vendimeve nga grupet e punës sipas rasteve të parashikuara në ligj. Nga ky vlerësim rezultuan të dhënat si më poshtë:

Agjencia e Trajtimit të Pronave nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015 deri në publikimin e fundit në Buletinin e njoftimeve zyrtare nr.46, datë 19.12.2019 ka vlerësuar ***gjithsej 26 091 vendime*** përfundimtare për kompensim të viteve 1993 – 2013, vlerësim prej të cilit rezultuan të dhënat si më poshtë:

- ▶ **18728** vendime u vlerësuan financiarisht me një vlerë prej **101,012,832,897 lekë**, vlerë e cila pritët të ndryshojë pasi ATP-ja është në pritje të përfundimit të ankimimeve nga subjekti në bazë të afateve ligjore;
- ▶ **2823 vendime të publikuara pa vlerë financiare** (dosje me mangësi dokumentacioni)
- ▶ **3715** vendime konsiderohen të kompensuara referuar nenit 7, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 133/ 2015 dhe pikës 3, gërma “c/ii” të VKM-së nr. 223/2016 i ndryshuar.
- ▶ **825** vendime të dublikuara*

Ecuria e procesit të vlerësimit financiar në ATP 2016-2019 (për vendimet 1993-2013/4)




*825 vendime nga procesi i vlerësimit rezultojnë të dubluara për arsyet;

- I njëjti vendim ndodhet në dy dosje, pasi prona për të cilin është dhënë ky vendim është pronë kufitare për një vendim tjetër. Kjo bëhet për lehtësimin procedurash lidhur me pozicionin, të dhënat e pronësisë etj.

- Në ATP janë administruar një numër kërkesash me objekt plotësimin, ndryshimin, shfuqizimin e vendimeve të vjetra të ish- KKKP-ve, për të cilat janë hapur dosje të ndryshme.

- Për të njëjtin objekt kërkimi, i cili lidhet me një vendim, secili nga trashëgimtarët e subjekteve kanë administruar kërkesa, për të cilat janë hapur dosje të ndryshme.

Vendime te viteve 1993-2013/ 4 te vlerësuara pas miratimit te ligjit 133/2015



1.2. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2019, ATP ka regjistruar pranë sporteleve **149 aplikime** për kompensim financiar / fizik dhe janë ekzekutuar **59 vendime** me të drejtë kompensimi financiar dhe nga fondi i tokës dhe për **22 vendime** është vendosur mbyllje procedimi. Gjatë 2019 janë shpërndarë:

- ▶ nga Fondi Financiar, **një vlerë prej 113,786,500.63 lekë**
- ▶ nga Fondi i Tokës, një sipërfaqe prej **231.968 ha** e barazvlefshme me një vlerë financiare prej **479,449,812.38 lekë**.

Për kompensimin financiar me *kërkesë të veçantë*:

Gjatë periudhës **Janar - Dhjetor 2019**, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve me kërkesë të veçantë rezultojnë:

- ▶ Kanë aplikuar **115** subjekte, dhe gjatë vitit janë marrë në shqyrtim administrativ **190** dosje;
- ▶ Janë trajtuar me vendim **97 aplikime**, nga të cilat për **86 aplikime** ATP ka vijuar me levrimin e kësteve, ndërsa për **11 aplikime** është vendosur mbyllje e procedimit administrative;
- ▶ Fondi i lëvruar (*fondi që do të lëvrohet përgjatë viteve 2019-2023*) për këto **86** vendime është në total **vlera 1,168,641,118.58 lekë**
- ▶ ATP ka lëvruar vlerën **250'593'882.03 lekë**;
- ▶ Kursimi i Buxhetit të Shtetit është **1'808'648'186.82 lekë**;
- ▶ Gjithashtu, në fillim të vitit kalendarik është lëvruar kësti i rradhës për **71 aplikime** përgjatë viteve 2016-2018, të cilat kanë marrë kestin e dytë, të tretë dhe kestin e katërt, në vlerën **259'270'754,19 lekë**.


Nga hyrja në fuqi e ligjit të ri, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka ekzekutuar për **682 vendime, nga këto 616 kompensim financiar me një vlerë prej 5,791,122, 519.66 lekë dhe 66 vendime me mbyllje procedimi**:

- ▶ **Gjatë vitit 2016; janë ekzekutuar 190 vendime duke shpërndarë një fond për kompensim financiar prej 1 826 870 845 lekë në total. (1 805 417 553 lekë për kompensim financiar dhe 21 453 292 lekë për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);**
- ▶ **Gjatë vitit 2017; janë ekzekutuar 179 vendime duke shpërndarë një fond për kompensim financiar prej 2 056 845 314 lekë në total (1 959 411 055 lekë për kompensim financiar dhe 97 434 259 lekë për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);**
- ▶ **Gjatë vitit 2018; janë ekzekutuar 102 vendime duke shpërndarë një fond për kompensim financiar prej 1 543 025 978, 56 lekë në total (35 521 553 lekë për kompensim financiar dhe 1 507 504 425, 56 lekë për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);**
- ▶ **Gjatë vitit 2019; janë ekzekutuar 145 vendime duke shpërndarë një fond për kompensim financiar prej 364,380,382.66 lekë në total (113,786,500.63 lekë për kompensim financiar dhe 250'593'882.03 lekë për kompensim financiar me kërkesa të veçanta dhe janë planifikuar për t'ju disbursuar për subjektet sipas kërkesës në vite dhe 1,168,641,118 lekë).**

Nga hyrja në fuqi e ligjit të ri, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka shpërndarë nga Fondi Fizik i pronave një sipërfaqe prej **612.3 Ha**, me një vlerë financiare prej **1.259,309,912.38 lekë**, si vijon:

- ▶ **Gjatë vitit 2016** u shpërnda një sipërfaqe prej **658 899 m2 (65.9 ha)** me një vlerë financiare prej 140,425,603 lekë.
- ▶ **Gjatë vitit 2017** u shpërnda një sipërfaqe prej **2 575 064 m2 (257.5 ha)** me vlere financiare 522,796,506 lekë.
- ▶ **Gjatë vitit 2018** u shpërnda një sipërfaqe prej **568 909 m2(56.9 ha)** me një vlerë financiare prej 116 637 991 lekë;
- ▶ **Gjatë vitit 2019** u shpërnda një sipërfaqe prej **2,319,678.46 m2(231.97 ha)** me një vlerë financiare prej 479,449,812.38 lekë.


Paraqitje Grafike e fondit fizik të shpërndarë 2016-2019



Nga hyrja në fuqi e ligjit të ri janë kryer ekzekutime të vendimeve për kompensim si në tabelë:

Trajtimi i kërkesave të vecanta pas miratimit të ligjit 133/2015	2016		2017		2018		2019		Totale	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Numri dhe vlera e vendime të ekzekutuara për kompensim me kërkesë të vecanta	4	15,852,437	12	52,748,653	86	538,001,692	86	250'593'882.03	188	857,196,664.03
Vlera e llogaritur për kompensim financiar e kërkesave të vecanta		21,453,292		97,434,259		1,507,504,426		1,168,641,118.58		2,795,033,095.58
Vlera e kursyer shtetit		70,416,155		251,197,331		3,010,751,267		1'808'648'186.82		5,141,012,939.82

Paraqitje Grafike e fondit të kursyer buxhetit të shtetit nga kompensimi me kërkesa të vecanta, pas miratimit të ligjit 133/2015 (2016-2019)



1.3. Për përfitimin e shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)

Pranë ATP-së kanë aplikuar **1480** qytetarë për periudhën janar-dhjetor 2019

- Janë ekzekutuar gjithsej **1249** kërkesa dhe është shpërndarë vlera financiare prej **1,648,240,646.60** lekë.

1.4. Për procesin e tjetërsimit të sipërfaqeve të shtetërore (oborreve në përdorim)

Bazuar në VKM nr. 578 datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, ndryshuar me VKM nr. 790 datë 14.11.2012. Për një ndryshim në vendimin nr. 578, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, rezulton se gjatë periudhës janar – dhjetor 2019

- ▶ Kanë aplikuar gjithësej 133 subjekte për vitin 2019 nga Bashki të ndryshme;
- ▶ Janë kryer verifikime në terren 216;
- ▶ Janë kryer vlerësime tekniko ligjore 240;
- ▶ Janë me vendimmarrje **214 kërkesa**.

Periudha	Periudha në vite				Totali dosje
	2016	2017	2018	2019	
Numri i aplikimeve per hapje dosje nga qytetare per oborret ne perdorim	137	135	171	133	Dosje ne sektor te pashqyrtuara 680
Numri i vendimeve per trajtimin e kerkesave qytetare per oborret ne perdorim	137	170	510	214	Numri total ivendimeve 1031

2. Trajtimi i numrit të kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara të ndara sipas qarkut dhe në shkallë vendi si dhe për llojin e pasurisë së pretenduar

2.1. Trajtimi i kërkesave të reja të depozituara për njohje pronësie

Në zbatim të ligjit 133/2015, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, dhe VKM-së nr. 222, datë 23.02.1016, “Për trajtimin e kërkesave për njohje të së drejtës së kompensimit të pronës”, ndryshuar, rezulton se:

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përfunduar trajtimin në total të **9 512** kërkesave, deri në përfundim të afatit 3 vjeçar, të këtij procesi, i cili përfundoi me datë 23 shkurt 2019, (pika 1 e nenit 34 i ligjit 133/2015, citojmë: “Procesi i shqyrtimit të dosjeve, që janë aplikuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që janë në proces shqyrtimi pranë Agjencisë, përfundon brenda 3 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji).

ATP ka regjistruar në total **16 462** kërkesa të patrajuara (kërkesa të depozituara me ligjet e mëparshme dhe kërkesa të reja sipas ligjit 133/2015), Gjatë periudhës 3 vjeçare janë trajtuar me vendim **9512** kërkesa.

Tabela me të dhënat statistikore të kërkesave të trajtuara nga ATP

Indikatorët	Total kërkesash të trajtuara ne vitin 2016	Total kërkesash të trajtuara ne vitin 2017	Total kërkesash të trajtuara ne vitin 2018	Total kërkesash të trajtuara 1 janar – 23.2. 2019	Totali i kërkesave te trajtuara
Numri i kërkesave të trajtuara për njohje pronësie	983	2529	3000	3000	9512

Agjencia e Trajtitimit të Pronave mbështetur në pikën 2 të nenit 34 **“Afati i përfundimit të procesit”**, për 6950 kërkesat e patrajuara ka vijuar me proceduar e njoftimeve duke bërë me dije se për njohjen dhe kompensimin e pronës së pretenduar subjektet kërkesat mund t’i drejtohen gjykatës së shkallës së parë, të vendit ku ndodhet prona, sipas kushteve të parashikuara në ligjin 133/2015, ku citohet se: *“Nëse ATP-ja nuk përmbush detyrimin për të trajtuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, brenda afatit 3-vjeçar, atëherë subjektet mund t’i drejtohen gjykatës së shkallës së parë për të trajtuar kërkesën e tyre, sipas përcaktimeve të këtij ligji”*.

Nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave gjatë periudhës raportuese (janar-dhjetor 2019) rezulton se:

- ▶ Janë njoftuar 6800 subjekte kërkesat të cilët vijnë në cilësinë e trashëgimtar ligjor/përfaqësues me prokurë (ky numër i referohet numrit të dosjeve), për të tërhequr dokumentacionin tekniko/ligjor të depozituar, në mënyrë që të fillojnë me procedurat pranë gjykatës së shkallës së parë;
- ▶ Janë depozituar 3197 kërkesa nga subjektet për të tërhequr dokumentacionin tekniko/ligjor në dosjet respektive dhe janë tërhequr 3109 dosje;
- ▶ Janë kryer 1880 kthim përgjigje subjekteve kërkesat dhe institucioneve zyrtare me objekte të ndryshme në kërkesat e tyre.

Nr.	Emertimi i procedurave	numri
1	Nr.total i dosjeve per trajtim	16462
2	Nr. dosjeve te trajtuara	9512
3	Nr. dosjeve te patrajuara	6950
4	Nr.njoftimeve per terheqje dosje	6800
5	Nr.dosjeve te terhequra	3109

2.2. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim

Në zbatim të ligjit 133/2015, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, VKM-së nr.222 datë 23.02.1016, “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj” dhe VKM-së nr.770/2014 “Për Kalimin në Fondin e Kompensimit Fizik, në Dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23 368.8 Ha”;

- ▶ Janë dërguar kërkesa për konfirmime për 1700 numra pasurie drejt institucioneve të ZVRPP-ve & Bashki-ve në Qarqet; Elbasan, Korçë, Berat, Gjirokastrë dhe për dijeni Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën ka kërkuar bashkëpunimin e institucioneve për të përfunduar sa më shpejtë procesin e verifikimit.
- ▶ Kanë ardhur në total përgjigjet nga ZVRPP Gramsh për **362 numra pasurie**.

- ▶ Janë kryer verifikime në terren të Fondit Tokës për kërkesat e subjekteve për kompensim të aplikuar në ATP. Janë verifikuar pasuri të ndodhura në qarqet Gjirokastrë, Berat, Korçë dhe Elbasan, dhe këto pasuri kanë kaluar në favor të ATP-së për t' u përdorur si Fond Kompensimi Fizik.

Nga ATP për periudhën janar-dhjetor 2019 janë verifikuar në total **612.3 Ha**

3. Çështjeve të ndjekura e të ankimuar në gjykatë dhe ekzekutimi i tyre

Një nga detyrat e ATP-së është dhe mbrojtja e interesave të ATP në tre shkallët e gjyqësorit dhe në gjykatën Administrative për vendimet e dhëna ndër vite, bazuar në legjislacionin në fuqi, është ndjekur si më poshtë:

Përfaqësim Ligjor pranë gjykatave; për periudhën janar –dhjetor 2019 rezulton:

Për periudhën nga Janari deri në dhjetor 2019 në Sektorin e Përfaqësimit Ligjor janë depozituar 2344 padi në të gjitha gjykatat e vëndit, në gjykatat e rretheve, në gjykatat e apelit, në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe në apelin administrativ.

- ▶ Janë administruar padi për periudhën 2344 padi të reja nga të gjitha gjykatat e rretheve;
- ▶ ATP ka ushtruar 69 ankime dhe 155 rekurse;
- ▶ 3 numri I ekzekutimeve vendimesh gjyqësore
- ▶ Janë rrëzuar nga gjykata 212 padi
- ▶ Janë pranuar nga gjykata 144 padi
- ▶ Janë kthyer dhe pushuar nga gjykata 211 padi

Për periudhën nga miratimi ligjit 133/2015 deri më 30 dhjetor 2019 pranë ATP-së janë depozituar:

- ▶ Në lidhje me vendimarrjen e ATP sa i takon njohjes të së drejtës së pronësisë sipas kushteve të nenit 29 të ligjit 133/2015 janë administruar **571 padi** nga ku rezultojnë:
 - Pranuar 39 padi
 - Rrezuar 56 padi
 - Kthim aktesh dhe pushuar 71 padi
- ▶ Në lidhje me vlerësimet financiare për vendimet që kanë njohur të drejtën e kompensimit sipas kushteve të nenit 19 të ligjit 133/2015 janë depozituar në ATP 442 padi ku kundërshtohet vlerësimi financiar i vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit nga këto:
 - Janë pranuar 84 padi
 - Rrezuar 144 padi
 - Kthim aktesh ose pushuar 73 padi
- ▶ Pas mbylljes së afateve ligjore për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie, si dhe vlerësimeve financiare të vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit sipas kushteve të nenit 15 të ligjit 133/2015 janë depozituar:
 - 93 padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë
 - Pranim 13 padi
 - Rrezuar 11 padi

- Kthim aktesh pushuar 13 padi
- Në lidhje me procedurat sipas kushteve të nenit 34 të ligjit 133/2015 janë depozituar:
 - 656 padi në Gjykatat e Shkallës së Parë Civile.
 - Pranuar 8 padi
 - Rrezuar 1 padi
 - Kthim aktesh pushuar 54 padi

4. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucione të tjera

Agjencia e Trajtimit të Pronave në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

4.1. Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të ligjit 133/2015

Raportime institucionale pranë Ministrisë së Drejtësisë referuar shkresave dhe informacionit të kërkuar për çështjen e pronave nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, siç vijon:

- Raportime institucionale në zbatim të ligjit 133/2015 sipas afateve të përcaktuara 3 mujore, 6 mujore, 9 mujore dhe vjetore.
- Kontributi “Mbi takimin e dhjetë të Komitetit të Stabilizim – Asociimit, KSA 2019”, zhvilluar në Bruksel, më datë 14 nëntor 2019.
- Kontributi për iniciimin e hartimit të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2020 – 2022.
- Kontributi me informacionin institucional në kuadër të monitorimit të Strategjisë për Zhvillim dhe Integritet II 2016-2020.
- Plotësimi i tabelave të kapaciteteve institucionale dhe administrative përsa i përket kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.
- Kontributi i parë për hartimin e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020.
- Raportime lidhur me Planin e Masave për rekomandimet e Progres Raportit të vitit 2019, në lidhje me Kapitullin 23.
- Kontributi mbi zbatimin e “Strategjisë Ndër sektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, raportuar me intervale 3 mujore.
- Përgatitja e materialeve për takimin e njëmbëdhjetë të Nënkomitetit “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, takim i cili u zhvillua në 24 prill 2019, në Bruksel.
- Materiale të përgatitura në kuadër të takimit të njëmbëdhjetë të Nënkomitetit për Çështjet ‘Ekonomi, Financë dhe Statistikë’, takim i cili u zhvillua me datë 3 tetor 2019 në Bruksel.
- Përditësime të informacioneve lidhur me të dhënat të pronës, si një nga prioritetet e qeverisë.

4.2. Raportime periodike Mujore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS)


Evidence e raportimeve periodike mujore pranë ZOS janar-dhjetor 2019

INDIKATORI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Aplikime te plota	1006	1519	2233	1779	1435	956	839	479	887	1084	695	379	13291
Aplikime te paplota	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Aplikime te mbartura	283	430	1150	838	475	282	233	226	346	328	284	167	5042
Total I sherbimeve te levruara	474	839	840	742	715	450	464	182	354	577	280	154	6071
Sherbime te levruara brenda afatit	414	759	769	718	679	436	414	150	321	544	269	142	5615
Sherbime te levruara jashte afatit	60	80	71	24	36	14	50	32	33	33	11	12	456
Plotesim dokumentacioni	66	91	23	18	10	4	5	2	14	24	15	8	280
Ankesa te reja	6	9	14	11	20	12	12	3	4	4	4	4	103
Ankesa te mbartura	41	39	41	46	46	54	55	30	29	22	22	26	451
Nr.pergj I ankesave te zgjidhura/shqyrtuara	8	7	9	11	12	11	37	4	11	4	0	6	120
Nr.ankesash te zgjidhura/shqyrtuara brenda afatit	2	7	3	8	9	9	9	2	5	4	0	4	62
Nr.ankesash te zgjidhura/shqyrtuara jashte afatit	8	0	6	3	3	3	28	2	6	0	0	2	61
Aplikime per kompensim nga ALUIZNI	131	102	186	139	185	188	104	52	146	121	90	36	1480
Aplikime per sherbime me vendimmarrje prane sektorit te tjetersimit te Oborreve	16	11	5	17	16	16	7	5	10	12	17	4	136
Aplikime per kalimin e praktikave ne cilesine e dosjes prane sektorit te Shqyrtimit	5	11	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	16
Aplikime prane sektorit te kompensimit Financiar dhe Fizik	21	20	24	20	18	6	9	4	11	15	6	4	158
Aplikime per sherbime pa vendimmarrje	823	1361	2013	1590	1200	736	702	410	714	929	579	329	11386
Aplikime per Kompensim progresiv													
Aplikime per kerkesa te vecanta	10	14	5	13	16	10	17	8	6	7	3	6	115

Raportime periodike Mujore pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS) për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Ëeb-Gis.

Indikatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	TOTALI
Nr i vendimeve ne dosjet e skanuara	341	519	44	412	369	308	259	0	264	125	31	64	2736
Nr.vend.te hartografuara	199	341	19	1621	540	10	2	0	9	6	3	5	2755

Paraqitje grafike e indikatoreve skanimeve/ hartografime nga ËEB-GIS janar-dhjetor 2019



5. Kërkesa të depozituara pranë sporteleve të atp-së si dhe ankesa të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes

5.1. Kërkesa të depozituara në sportelet e ATP-së

Për periudhën janar-dhjetor 2019 pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave në lidhje me shërbimet që ofrohen ndaj qytetarëve, janë trajtuar:

- Shkresa hyrëse 14621, 12666 shkresa me përgjigje, 1207 shkresa në trajtim dhe 748 numri shkrësive të cilat nuk kërkojnë përgjigje se janë; plotësim dokumentacioni, kërkesa për takime me specialist të ATP-së, kërkesë për tërheqje dokumentacioni dhe nuk ka ardhur të marr përgjigjen subjekti.
- Në sportelet e Marrëdhënieve me Publikun janë depozituar **6236 kërkesa qytetare**, nga të cilat:
 - ▶ Kërkesa për informacion – 1172
 - ▶ Kërkesa për kopje dokumentacioni - 1292
 - ▶ Plotësim dokumentacioni – 602
 - ▶ Kërkesa për vlerësim vendimi – 180
 - ▶ Metodologji Vlerësimi – 229
 - ▶ Takime – 295
 - ▶ Ankesa/ Të ndryshme (Oborre/Ekzekutim Vendime/Perfitime Kompensimi etj) -343
 - ▶ Kërkesa për Tërheqja Dosje – 2123



5.2. Ankesa të trajtuara të ardhura nga portali i bashkëqeverisjes

5.2.1. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer raportimin periodik për vitin 2019 në kuadër të monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020

Për periudhën janar-dhjetor 2019 nga Kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe i denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në Agjencinë e Trajtimit

të Pronave rezultojnë **6 ankesa** të trajtuara nga Grupi i Punës Anti Korrupsion, vetëm për **dy raste** janë marrë masa disiplinore si vijon:

- ▶ Çështja nr.90671 datë 23.01.2019 - ka rezultuar se punonjësi ka kryer shkelje e kodit të etikës dhe tejkalim të kompetencave e tij funksionale bazuar në Rregulloren e ATP-së **duke u marrë masa disiplinore largim nga detyra**.
- ▶ Çështja nr.115190 datë 04.04.2019 - pas hetimit të rastit nga grupi i punës, u vlerësua se nuk ka shkelje të kodit të etikës dhe rregullores së brendshme të ATP-së dhe veprës penale të korrupsionit.
- ▶ Çështja nr.137202 datë 25.06.2019 - pas hetimit të rastit nga grupi i punës, u vlerësua se nuk ka shkelje të kodit të etikës dhe rregullores së brendshme të ATP-së dhe veprës penale të korrupsionit.
- ▶ Çështja nr.146620 datë 15.08.2019 - pas hetimit të rastit nga grupi i punës, u vlerësua se nuk ka shkelje të kodit të etikës dhe rregullores së brendshme të ATP-së dhe veprës penale të korrupsionit.
- ▶ Çështja nr.164239 datë 18.11.2019 - pas hetimit të rastit nga grupi i punës, u vlerësua se ka shkelje të kodit të etikës dhe tejkalim te kompetencave funksionale, duke u marre masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim per shkarkim nga detyra”.
- ▶ Çështja 172449 datë 18.11.2019 – pas hetimit të rastit nga grupi i punës, u vlerësua se nuk ka shkelje të kodit të etikës dhe rregullores së brendshme të ATP-së dhe veprës penale të korrupsionit.


Ankesat jane paraqitur nepermjet Platformes se Bashkeqeverisjes.

5.2.2. Pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë trajtuar ankesat të paraqitur nga nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes me qytetarët.

Nga janar deri në dhjetor 2019, janë trajtuar me përgjigje **667**, ankesa qytetarësh të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, të trajtuara me përgjigje, nga të cilat:

- ▶ 6 Mujori i parë (Janar - Qershor 2019) – 455 Ankesa të trajtuara.
- ▶ 6 Mujori i dytë (Korrik – Dhjetor 2019) 212 Ankesa të trajtuara nga te cilat :
 - 171 kërkesë/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e kompensimit financiar/fizik.
 - 188 kërkesa/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e vendimmarrjes për Njohjen e Pronësisë.
 - 36 kërkesa/ankesa për Sektorin e Oborreve në përdorim
 - 11 kërkesa/ankesa për Sektorin e Përfaqësimit Ligjor
 - 43 kërkesë/ankesë e cila ka lidhje procesin e shqyrtimit të kërkesave për kompensimin në vlerë të ish pronarëve tokat e të cilëve janë zënë me ndërtime informale
 - 218 ankesa për Sektorin e Protokollit/Arkivës/Mardhënieve me Publikun

Indikatorët ATP	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Numri i kërkesë /ankesë të ardhura nga qytetarët në sportele dhe portale elektronike	5682	3895	6583	16136	2552	1621	667



5.3. Shërbime të ofruara nga ATP nga bashkpunimi ndërmjet AKSHI dhe ADISA

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional të ATP-së me AKSHI-n dhe ADISA për krijimin dhe funksionimin e dy shërbimeve elektronike nga portali qeveritar e-albania, nga ATP-ja ka vijuar puna me shërbimet elektronike e bëra publike :

- ▶ Ankesë dhe trajtimi i dosjes me specialistin përkatës pranë ATP
- ▶ Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes

Stafi i ATP “si përdorues të Portalit Qeveritar” merret me procedurat e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe akseson nga sistemi dokumente si çertifikata për qytetarët.

- ▶ Nga Portali ONE STOP SHOP kryhet Gjenerimi i dokumentacionit (çertifikata).

Agjencia e Trajtimit të Pronave në bashkëpunim me ADISA ka kryer hartimin dhe validimin e kartelave Informative të Shërbimeve që ofron për qytetarët, duke i bërë publike ato.

Për vitin 2020 nga Agjencia e Trajtimit të Pronave do të vijoj procesi i identifikimit dhe përcaktimit të shërbimeve të tjera që do ti ofrohen qytetarëve në mënyrë elektronike nga portal i bashkqeverisjes e-albania. Nga stafi ATP po punohet bazuar në Manualin e përdorimit të vënë në dispozicion nga AKSHI “Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik”.

Manuali shërben si udhëzues për nëpunësit e institucionit të ATP-së për ti dërguar kërkesën për dokument shoqërues atij institucioni (subjekti) ose një institucioni tjetër në varësi të aplikimit të kryer në portalin qeveritar e – albania. Çdo përdorues është identifikuar në mënyrë unike në sistem. Regjistrimi i tyre realizohet nga një administrator i përgjithshëm TI, i cili është përgjegjës për konfigurimet e ndryshme të sistemit

6. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompesimit

6.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2019 duke u bazuar në 12 mujor deri ne 26.12.2019, i pa kuadruar nga dega e thesarit

Nr	EMËRTIMI	Llog. Ekonomike.	Buxheti 2019/ Pas aktit Normativ	Plani 12 Mujor	Fakti 12 Mujor
----	----------	------------------	----------------------------------	----------------	----------------

1	Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	600	138,000,000	138,000,000	126,640,688
2	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shendetësore	601	22,800,000	22,800,000	21,044,370
3	Mallra dhe shërbime të tjera	602	74,000,000	74,000,000	33,982,206
4	Transferime korrente të brendshme	604	4,000,000,000	4,000,000,000	3,108,595,089
5	Transferta për Buxhetet familiare dhe individët(Fond I VECANTA)	606	200,000	200,000	0
6	Shpenz. Për rritjen e aktiveve të Trupëzuara	231	1,000,000	1,000,000	820,900
M140208	Rikonstruksione zyresh, ambiente etj	2310000	960,000	960,000	780,900
M140293	Supervizim projekti	2310000	28,000	28,000	28,000
M140294	Kolaudim projekt	2310000	12,000	12,000	12,000
Total Buxhetore 1+2+3+4+5+6			4,236,000,000	4,236,000,000	3,291,083,253
7	Te Ardhura Jashtë Buxhetore		1,000,000,000	620,830,158	620,830,158
TOTAL Buxhetore dhe Jashte Buxhetore			5,236,000,000	4,856,830,158	3,911,913,411

6.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, për vitin 2019

Nr	EMËRTIMI	Llog. Ekonomike.	Total	Komente
1	Tarifa për Aktet - Administrative	7110105	5,192,635	Derdhur në Buxhet përjudha 01.01.2019-30.11.2019. Muaji Dhjetor nuk ka përfunduar
2	Të ardhura nga Tjetërsimi i Sipërfaqeve Shtetërore	7110114	26,300,150	Të ardhura që merr ATP përjudha 01.01.2019-12.12.2019
3	Të tjera të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh	7111099	-	Derdhur në Buxhet
4	Të ardhura të krijuara nga pagesa e vlerës së llogaritur të tokës	7109901	1,920,500	Të ardhura që merr ATP përjudha 01.01.2019-12.12.2019
5	Të ardhura nga kalimi i pronësisë së pasurive të paluajtshme e të truallit funksional të tyre	7109902	-	Të ardhura që merr ATP
6	Të ardhura nga privatizimi i banesave shtetërore dhe objekteve të kthyera në banesa me fondet e shoqërive shtetërore	7109903	44,874	Të ardhura që merr ATP përjudha 01.01.2019-12.12.2019
7	Të ardhura nga shitja - tokë , troje e terene	1161110	329,565	Të ardhura që merr ATP përjudha 01.01.2019-12.12.2019
	Totali 2+4+6+7		28,595,089	Të ardhura që i shtohen ATP në fondin e kompensimit, në pritje për kalimin në thesar për në bankën e Shqipërisë
TOTAL			33,787,724	

Informacioni për të ardhurat janë të pa kuadruar nga thesari : Tarifa për Aktet - Administrative informacioni është 11 Muajor

INFORMACIONI I KONFIRMUAR NGA SEKTORËT:

Sektori i Kompensimit Financiar dhe Fizik

Ylli Gaxholli – Përgjegjës Sektori
Jonida Collaku – Inspektore

Sektori i Komp. me Kërkesa të Veçanta

Artan Musta – Përgjegjës Sektori
Zarina Sturce – Inspektor

Sektori i Shqyrtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie

Arjola Zoto – Përgjegjës Sektori

Sektori i Tjetërsimit të Sipërfaqeve Shtetërore

Vangjel Tata – Përgjegjës Sektori
Defrim Bulica, Inspektor

Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Media

Jetnor Haxhiaj, Pergj.Sektori
Iva Dokle - Kordinatore SMPM

Sektori i Përfaqësimit Ligjor

Emiljan Koja – Përgjegjës Sektori

Sektori i Financës

Entela Imeri – Përgjegjëse Sektori

Sektori Ëeb-Gis

Juliana Cenga, Inspektore

Sektori i Asistencës Ligjore & Projekteve

Ervehe Çumani – Përgjegjëse Sektori
Majlinda Nanaj, Inspektore
Rea Mucollari, Inspektor
Fabian Azuni, Inspektor